



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. ~~2848~~ / prot.  
1

Tiranë, më 3.12.2024

**VENDIM**

Nr. 146 , datë 3.12.2024

**PËR KUFIZIMIN E LICENCIMIT TË PILOTËVE**

Në mbështetje të pikës 6 të Nenit 70 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, për të siguruar zbatimin e Urdhrit të Ministrit Nr. 178, datë 20.12.2023 "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", në garantim të parandalimit të çënimeve të mundshme të sigurisë në operim,

**VENDOSA:**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të kufizojë procesin e licencimit të pilotëve deri në datë 5 dhjetor 2025, periudhë gjatë së cilës, AAC, në përputhje me rregullat në fuqi do të kryejë funksionet e validimit të licencave të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendeve të tjera sipas Aneksit 1 të ICAO-s dhe njohjen e licencave të lëshuara nga autoritetet kompetente të vende anëtare të BE-së.
2. Ngarkohet Drejtoria e Trajnimit dhe Licencimit në Autoritetin e Aviacionit Civil, që të hartojë dhe zbatojë planin e masave që mundëson kryerjen e funksionit të licencimit të pilotëve brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

Maksim Et'hemaj

